



Pranuar / Porezuar Priljen, Prifato Received/Delivered	28.06.2022	2	viti god year
Organ /Nesta Organ /Jednica Org. Unit	Hr Prot Hr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3781/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.559/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1983/21 të datës 13.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 3166/2021 të datës 18.06.2021 të parashtruar nga ankuesja _____ ne adresë banimi _____ kundër organit të punësimit- Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjakshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

I.DETYROHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëj rishqyrtimin e kërkesës me numër protokollit 2021/DSF/138,të datës 23.04.2021 të parashtruar nga ankuesja _____

II.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e caktuar në pozitën Zyrtare e aviacionit të përgjithshëm në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve sipas akt emërimit të datës 01.01.2017 i nënshkruar me datën 23.12.2016, më datën 23.04.2021 ka bërë kërkesë me numër protokollit 2021/DSF/138, për Drejtorin e Përgjithshëm të Aviacionit Civil të Kosovës për lëshimin e kredencialeve të inspektore.

Ankuesja për shkak të heshtjes administrative nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës lidhur me kërkesën e datës 23.04.2021, ka parashtruar ankesë me datën 18.06.2021 me numër protokollit 3166/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.06.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës. Me datën 02.07.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Këshilli më datë 02.08.2021 përmes shkresës me numër të protokollit 4025/2021, ka njoftuar ankuesen për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 18.06.2021 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 13.04.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1983/2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses [redacted] ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK-së e datës 02.08.2021 dhe detyron të njëjten që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditëses të datës 18.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3166/2021 të datës 18.06.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 23.04.2021 për lëshimin e kredencialeve të Inspektore; Kërkesë për nënshkrim të Lejes për operim GAT/VFR e datës 16.04.2021; Formular aplikimi për aprovim dhe regjistrim të sistemit të rrjetit ajror pa pilot(SAP) i datës 29.06.2020; Formulari i aplikimit për provim teorik për sistem të rrjeteve ajrore pa pilot (SAP) i datës 10.02.2018; Raporti i Auditimit i datës 25.04.2016; Plani Delta i datës 01.03.2019; Rekomandim për lëshimin e kredencialeve të Inspektore së Aviacionit të përgjithshëm për znj. [redacted] i datës 15.07.2020; Raport për mbylljen e ndodhive të raportuara të sulmeve me laser e datës 22.10.2019; Rekomandim për emërimin e [redacted] në pozitën Inspektore e Aviacionit të Përgjithshëm i datës 20.01.2021;Akt emërimi i datës 23.12.2016; Rregullore Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve e datës 25.09.2011; Shtojca 1; Udhëzimi Administrativ Nr.2/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit i datës 26.09.2011; Aplikacion për Kredenciale të Inspektorit; Formular vlerësimi për inspektor i datës 15.01.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 19.12.2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 24.12.2018; Çertifikatë e vitit 2019; Çertifikatë ECAC; Çertifikatë e vitit2014; Çertifikatë e vitit 2015; Çertifikatë e muajit mars 2014; Çertifikatë e vitit 2019; Çertifikatë e vitit 2016; Çertifikatë e vitit 2021; Delegim i Inspektorit -Inspektore e Aviacionit të Përgjithshëm [redacted] e datës 22.01.2020; E-mail zyrtar i datës 17.06.2021; E-mail zyrtar i datës 23.04.2021; E-mail zyrtar i datës 13.04.2021; E-mail zyrtar i datës 12.04.2021; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 15.03.2015; Njoftim i datës 26.04.2021 me nr.2021/ZDP/143; E-mail zyrtar i datës 06.05.2021; E-mail zyrtar i datës 28.04.2021; Kërkesë për nënshkrim të Lejes për operim GATIVAR i datës 16.04.2021; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 02.07.2021 me numër protokollit

3431 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/50 ; Njoftimi i datës 03.08.2021 me numër protokollit 4025/2021; Aktgjykimi A.nr.1983/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Administrative ; Parashtrësë për prova shitesë në lidhje me ankesën e datës 18.06.2021 të sjella nga [redacted] me autorizim të datës 19.08.2021; Raport javor i punës së Inspektorit; Lista e inspektorëve; Raporti i Avokatit të Popullit i datës 09.06.2022 me numër protokollit 889/2022; Raporti i Auditimit i muajit qershor 2015; E-mail zyrtar i datës 06.07.2022 dhe Çertifikatë e datës 01-03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet në institucionin përkatës (Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës) me qëllim që të detyrohet organi i punësimit të merrë në shqyrtim kërkesën e ankueses me qëllim që të nxjerret akti administrativë nga organi kompetent konformë dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesja me datën 23.04.2021 ka parashtruar kërkesë për Drejtorin e Përgjithshëm të Aviacionit Civil, me arsyetimin për lëshimin e kredencialeve, por deri më tani nuk ka reflektuar as me një përgjigje nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 18 paragrafi 1 pika 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pasur parasysh faktin se ankuesja ka bërë disa kërkesa në adresë të zyrtarëve kompetentë të institucionit përkatës që të rregullojë këtë çështje që lidhet me këtë ankesë, por se nga shkresat e lëndës dhe përgjigja nga institucioni kompetentë në lidhje me këtë ankesë nuk kemi hasur në ndonjë veprim konkretë administrativë që merrë në shqyrtim këtë kërkesë me qëllim që të nxjerrin ndonjë akt administrativë në lidhje me këtë kërkesë, andaj mbi këtë bazë të potencuar më lartë obligon Drejtorin Gjeneral të Autoritetit të Aviacionit Civil që të shqyrtojë kërkesën e ankuesës dhe me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 23.04.2021, të veproj konformë legjislacionit në fuqi që rregullonë këtë çështje duke nxjerrë një akt administrativë sipas kësaj kërkesë/ankese konformë dispozitave ligjore në fuqi, nga se kolegji vlerëson se është obligim i organit kompetentë të punësimit që të përgjigjet konformë dispozitave të LPPA-së (Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative) ndajë qdo kërkesë që adresohet përmes procedurave administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A nr.559/2021, 28.06.2022

Sabile AVDYLI
Sabile Avdyli
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankueses;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

